Numër: 01/491
Datë: 18.10.2021

Këshilli Drejtues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve - kanë shqyrtuar ankesën Nr.01/416 të datës 03.09.2021 të parashtruar nga ankuesi, Bujar Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit "IKAF", me adresë: Rr. Bedri Pejani, Nr.1, në Komunën e Prishtinës, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/399, të datës 20.08.2021, duke vepruar në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur me datë 13.10.2021 dhe 15.10.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër Nr.01/416 e datës 03.09.2021 e parashtruar nga ankuesi Bujar Krasniqi, për piken një (1) të ankesës, për kualifikimin: "Certifikim në IPSAS", shfuqizohet pika III e dispozitivit të vendimit të KD-së së AKK-së Nr.01/399, i datës 20.08.2021.

1.1. **Akreditohet** "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2021 deri me 19.08.2024 për kualifikimin: **Certifikime në IPSAS,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikimi i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 75 kredi të AAP. Institucioni mund të realizoj procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2. **Refuzohet si e pa bazuar** pika dy (2) e ankesës lidhur me pretendimin e ankuesit për kohëzgjatjen e riakreditimin e Institutit IKAF për profilin "Nëpunës i Kontabilitetit", e parashtruar, kundër pikës një (1) të dispozitivit të vendimit Nr.01/399, të datës 20.08.2021.

2.1. **Pika** një (1) e dispozitivit të Vendimi Nr.01.399, i datës 20.08.2021, i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve mbetet e pandryshuar.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke u bazuar në kërkesën e "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për validim dhe akreditim të institucioni si dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore ka nxjerr vendimin Nr.01.399, me te cilin vendim ka vendosur që të ri-akreditoi institutin IKAF për periudhën tre (3) vjeçare, duke filluar nga data 15.12.2021 deri 14.12.2023 për kualifikimin "Nëpunës i Kontabilitetit". Këshilli Drejtues në vendimin Nr:01/399 ka vendosur që institutit IKAF ti jep akreditim për periudhën tre (3) vjeçare, duke filluar nga data 20.08.2021 deri 19.08.2023 për kualifikimet: Nëpunës i Kontabilitetit, Kontabilist i Certifikuar, Auditor i Certifikuar, Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik, Vlerësues i Bizneseve i Certifikuar, Vlerësues i Bizneseve i Licencuar, Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare, Këshilltar Tatimor, Këshilltar Tatimor i Licencuar, Kontrollor i Certifikuar, Kontrollor i Licencuar, Auditor i IT i Certifikuar, Menaxher i Riskut i Certifikuar, CFO i Certifikuar dhe Zyrtar i Certifikuar ne Menaxhimin e Financave Publike i ka dhënë akreditim. Këshilli Drejtues duke u bazuar në raportet e akreditimit dhe validimit të eksperteve vlerësues në piken tre (3) të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet akreditimi i institutit "IKAF", për kualifikimin "Certifikim në IPSAS".

Instituti IKAF vendimin Nr.01/399, të datës 20.08.2021 të Këshillit Drejtues të AKK-së e ka pranuar me datë 20.08.2021.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.01/399 të datës 20.08.2021 të Këshillit Drejtues të AKK-së, bazuar në dispozitat ligjore, me datë 03.09.2021 parashtron ankesën me numër protokolli 01/416 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 01/416 të datës 03.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në AKK; Vendimi Nr.01/399, i datës 20.08.2021, i Këshillit

Drejtues; Kopjen e protokollit ku dëshmohet data e pranimit të vendimit të kontestuar të KD-së; Emalin zyrtar të datës 06.07.2021, nga znj. Donjeta Nimani (Zyrtare e AKK-së) për Institutin IKAF; Emali zyrtar i datës 13.07.2021, nga instituti IKAF, drejtuar AKK-së, ku janë parashtruar komentet e Institutit IKAF; Emali zyrtar i datës 07.10.2021, nga ekspertët vlerësues ku janë parashtruar qëndrimet e eksperteve vlerësues lidhur me ankesën e IKAF; Kërkesa Nr.02/475, e datës 13.10.2021, nga AKK, drejtuar eksperteve vlerësues për kualifikimin Certifikime në IPSAS; Mendimi profesional i eksperteve vlerësues i datës 14.10.2021.

Këshilli Drejtues i AKK-së, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi Bujar Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit IKAF është ***pjesërisht e bazuar, sepse:***

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka parashtruar ankesë kundër dispozitivit I dhe III të vendimit Nr.01/399 të datës 20.08.2021 të KD-së së AKK-së.

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se: Ekipi i eksperteve për vlerësimin e kualifikimit "Certifikime në IPSAS", nuk ka marr për bazë dëshmitë mbështetëse të ofruara nga Instituti KAF gjatë fazës së aplikimit deri në akreditim, andaj Instituti KAF konsideron që arsyetimet e dhëna nga ekipi vlerësues i ekspertëve të AKK për "Kualifikimin IPSAS" janë të pabaza dhe në kundërshtim me arsyetimet dhe dokumentet mbështetëse të ofruara nga Instituti KAF gjatë procesit të vlerësimit.

Pretendimet e dhëna në ankesën e parashtruar nga Instituti IKAF lidhur me refuzimin e akreditimit për kualifikimin "Certifikime në IPSAS", janë çështje profesionale, rrjedhimisht nga kjo është e pamundur që personat që nuk e njohin këtë fushë të japin vlerësime lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë, duke u bazuar në ketë Këshilli Drejtues i AKK , në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021 me votat e te gjithë anëtarëve prezent ka vendosur që lidhur me ankesën e institutit IKAF Nr.01/416, të datës 03.09.2021 që:

1. Të kërkoj nga ekspertët vlerësues që kanë qenë të angazhuar nga AKK për Institutin IKAF në profilin "Certifikime ne IPSAS", që të njëjtit të japin arsyetim me shkrim lidhur me dëshmitë/pretendimet e ankuesit ne ankesën e parashtruara me Nr.01/416 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

2. Ekspertet vlerësues, mendimin profesional ne formë te shkruar detyrohen që ta japin në afat kohor prej 48 orëve nga momenti i pranimit të kërkesës.

Këshilli Drejtues i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021, me votat e të gjitha anëtarëve prezent, ka vendosur që pas pranimit të mendimit të ekspertëve vlerësues për kualifikimin "Certifikime në IPSAS", për të njëjtin të votojnë në përputhje me nenin 41 të Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ekspertët vlerësues me datë 14.10.2021 përmes emailit zyrtar kanë dhënë mendimin profesional lidhur me pretendimet ankimore të Institutit KAF për kualifikimin "Certifikime në IPSAS" me çrast kanë theksuar se: "Këshilli drejtues i AKK përmes kërkesës Nr.02/475 të datës 13.10.2021 ka kërkuar qëndrimin profesional të komisionit vlerësues duke ju referuar ankesës së institutit KAF Nr.01/416, të datës 03.09.2021. Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dëshmive të ofruara në vijim do të paraqesim një përmbledhje si dhe vlerësim të gjendjes pas ankesës:
Procesi i vlerësimit për validim dhe akreditim për institucioni KAF ka qenë në fazën e kohës pandemie ku u jemi përmbajtur vendimeve nga instituti i shëndetit publik si dhe qarkores nga AKK për vizita në kohë pandemie.
Me qëllim për të ju shmangur kontaktit fizik përveç vizitës të gjitha komunikimet tjera i kemi pasur përmes shërbimeve të teknologjisë së informacionit, gjatë procesit ne kemi kërkuar dëshmi shtesë të cilat janë ofruar në mënyrë elektronike (dëshmitë janë bashkangjitur në një fajll të vetëm pdf ku pastaj dokumente të veçanta janë thirrur përmes hyperlinkut), në këtë fazë IKAF ka aplikuar paralel me 17 profile, ne si panel kemi qenë përgjegjës për 4 profile.

Pas shqyrtimit të ankesës së IKAF ndaj pikës 3 të Vendimit Nr.01/399 të datës 20.08.2021 të Këshillit Drejtues (KD) të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), ne paneli i ekspertëve kemi vërejtur dhe pastaj vërtetuar se dokumenti me titull i bashkangjitur në ankesën e fundit **Marrëveshjen me IFAC për përdorimin e Materialeve Studiuese,** nuk e kemi poseduar në dosje gjatë hartimit të draft raporteve vlerësuese, ky dokument është dërguar pas komenteve mbi draft raporteve të datës 13 korrik siç është cekur edhe në ankesë. Andaj për shkak të volumit të madh të dokumenteve të cilat kanë qenë si dhe problemeve teknike me disa linqe që disa herë janë paraqitur sepse shfletues (broëser) të ndryshëm nuk ishin kompatibil dhe kishte raste të mos hapeshin online ndonjë dokument deri sa të gjendej shfletuesi adekuat. Me datën 13 korrik ky dokument është dorëzuar në dosje por që ne paneli nuk e kemi vërejtur për shkak të problemeve teknike dhe nuk e

kemi marrë për bazë se na është dorëzuar në raportet finale të vlerësimit për këtë profil, për këtë ne kërkojmë falje dhe mirëkuptimin tuaj për këtë lëshim teknik.

Gjithsesi ky dokument tani merret në konsideratë si dhe vlerësohet si i rëndësisë së veçantë për profilin më saktë ndaj pikave nga komentet 3 dhe 7 nga ankesa e IKAF drejtuar KD të AKK.

Arsyetimi mbi mendimin profesional qëndron në vetë faktin që Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC- International Federation of Automatic Control), ka zhvilluar modulin "Train the Trainer: Introduction to IPSAS", dhe është e drejt ekskluzive e IFAC , përdorimi i materialeve pa autorizimin e IFAC , do të paraqiste shkelje e te drejtës se autorit nga ana e Institutit, dhe pa marrjen e te drejtës për shfrytëzim te materialeve dhe modulit si tersi Instituti nuk ka mundur të zhvilloj ketë program. PRA me këtë rast IKAF mbulon këtë të drejt përmes këtij dokumenti si marrëveshje për lejim dhe përdorim të kësaj të drejte që për panelin është shumë me rëndësi posedimi i këtij dokumenti për zhvillimin e kualifikimit.

Sa i përket pikave te tjera te ankesës paneli i eksperteve ka dhëne komentet ne raport konform kornizës raportuese te ofruar nga AKK (pra vlerësimi i dhëne nga paneli i ekspertëve bazuar ne formatin e AKK), dhe ne asnjë mënyrë nuk bie ndesh me realitetin objektiv apo ti këtë mohuar Institutit te drejtën e zhvillimit te këtij programi, në mënyrë që mos të konsiderohet qasje tendencioze pasi përkundrazi gjatë gjithë procesit qasja ka qenë afirmative dhe e vlerësimit objektiv për të gjitha programet kualifikuese, sepse nga pikat e ankesës shifet te jete menduar te ofrohen dëshmi, por ne esence nuk paraqesin ne vetvete dëshmi sepse si panel kemi paraqitur në raport të validimit rëndësinë qe ka trajnimi tek Pjesa 3. Vlerësimi i kualifikimit/modulit sipas kritereve të përgjithshme të validimit.

Nëse nga KD (Këshilli drejtues) i AKK do të ishte kërkuar mendimi për vlerësim përfundimtar për profilin pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dëshmive të ofruara atëherë ne paneli rekomandojmë validimin dhe akreditimin sipas rekomandimeve dhe komenteve që janë paraqitur në raportet vlerësuese të jashtme për validim dhe akreditim. Numri i kandidatëve për këtë profil në një grup maksimum mundë të jetë 25 kandidatë dhe brenda vitit në maksimum mund të organizohen 2(dy) grupe, pra ngjashëm me propozimet për programet e tjera".

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në mendimin e eksperteve vlerësues të dhënë pas parashtrimit të ankesës së Institutit KAF lidhur me mos akreditimin për kualifikimin "Certifikime në IPSAS" vendosi si në piken një (1) të dispozitivit.

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se: nga vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i AKK-së shumica absolute e organizatave që janë ri-akreditуar në kualifikimin e caktuar kanë pranuar ri-akreditim për periudhën pesë (5) vjeçare. Andaj, meqenëse Instituti IKAF ka pranuar raport vlerësues pozitiv nga paneli vlerësues për këtë kualifikim kërkon të marr në konsideratë ri-akreditimin për periudhë pesë (5) vjeçare.

Këshilli Drejtues i AKK-së, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se nga vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i AKK-së shumica absolute e organizatave që janë ri-akreditуar në kualifikimin e caktuar kanë pranuar ri-akreditim për periudhën pesë (5) vjeçare. Andaj, meqenëse Instituti IKAF ka pranuar raport vlerësues pozitiv nga paneli vlerësues për këtë kualifikim kërkon të marr në konsideratë ri-akreditimin për periudhë pesë (5) vjeçare, nga shkresat e lëndës, respektivisht raporti vlerësues për akreditim i eksperteve vlerësues i cili ka theksuar se: Ri-akreditohet "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", për periudhën tre (3) vjeçare, për kualifikimin "Nëpunës Kontabiliteti". Bazuar në vendimin Nr.01/105 të datës 13.10.2017 të Këshillit Drejtues të AKK-së, konstatohet se Instituti "IKAF" për kualifikimin "Nëpunës i Kontabilitetit", ka qenë i akreditуar për periudhën nga data 15.09.2017 deri me 15.09.2020, duke ia shtuar kësaj edhe afatin kohor prej tre (3) muajve bazuar në vendimin Nr.01/2020 të datës 23.06.2020 lidhur me pengesat që ka shkaktuar pandemia COVID 19 ne funksionimin e institucioneve, atëherë Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në të lartcekurat dhe në raportin për riakreditim dhe rivalidim të ekspertëve vlerësues ka vendosur që Institutin "IKAF" për kualifikimin "Nëpunës Kontabiliteti" ta ri-akreditoj për periudhën kohore nga data 15.12.2020 deri 14.12.2023. Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e nxjerrjes se vendimit Nr.01/399 të datës 20.08.2021 ka vepruar në përputhje me paragrafin 2 të nenin 8 të Rregullores Nr.01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimit (KKK) dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP), i cili përcakton se: **"Procedura e riakreditimit dhe rivalidimit është e njëjtë me procedurën paraprake, përveç nëse parashihet ndryshe me dispozita ligjore në fuqi"**, rrjedhimisht nga kjo konstatohet se ankuesi ka dështuar që të argumentoj se Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e nxjerrjes se vendimit Nr.01/399 të datës 20.08.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar.

Këshilli Drejtues i AKK-së konstaton se legjislacioni me të cilin rregullohet akreditimi i institucioneve që ofrojnë kualifikime ne Republikën e Kosovës ne asnjë vend nuk e

thekson obligimin e AKK-së që në rast të ri-akreditimit të institucionit/kualifikimit AKK është i detyruar që këtë ta bëjë për periudha me te gjate kohore se sa periudha tre vjeçare. Sipas paragrafit 1 të nenit 22 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, përcaktohet se: **"Kohëzgjatja e procesit të aprovimit apo akreditimit është maksimumi deri në 3 (tre) vite në rastin e parë"**, rrjedhimisht nga kjo konstatohet se AKK ka mundësi, por jo obligim ligjor që me rastin e riakreditimit të institucionit, këtë ta bëjë për periudhë me të gjatë se periudha tre (3) vjeçare.

Bazuar në legjislacionin që rregullon kualifikimet kombëtare në Republikën e Kosovës, dallimin e vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me riakreditimin e institucioneve është theksuar në paragrafët 4.4, 4.5 dhe 4.6 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, rrjedhimisht nga kjo që u cek me lartë Këshilli Drejtues i AKK-së konstaton se vendimi Nr.01/399 të datës 20.08.2021 e ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe e ka zbatuar drejt legjislacionin në fuqi dhe se pretendimi i ankuesit është i pabazuar në fakte dhe i pambështetur në legjislacionin në fuqi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit Drejtues të AKK-së nuk është i ligjshëm mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK